MUSINE KOKALARI
Instituti për Politika Sociale
Institut za Socijalne Politike - Institute for Social Policy

ANALIZË E POLITIKAVE

Shërbimet sociale pas Raportit për Kosovën 2026:

Financim i qëndrueshëm për nevojat lokale

Nëntor 2026

Mesazhet kryesore

- Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2026 vlerëson se progresi në politikën sociale ka qenë i kufizuar dhe se shërbimet sociale nuk kanë financim shumëvjeçar dhe staf të mjaftueshëm. Komisioni rekomandon një grant specifik për shërbimet sociale.
- Në Prizren, Istog, Kamenicë dhe Graçanicë kemi parë të njëjtin problem: komunat kanë përgjegjësi për shërbimet sociale, por shpesh nuk kanë fonde dhe staf për t'i ofruar ato.
- Kur shërbimet mungojnë, kujdesin për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara e marrin përsipër familjet, kryesisht gratë. Kjo ua kufizon mundësinë për të punuar. Prandaj, financimi i shërbimeve sociale është edhe investim në punësimin e grave dhe në barazinë gjinore.
- Granti specifik është hapi i parë, por vetëm paratë nuk mjaftojnë. Kërkojmë që Qeveria të caktojë afatin për krijimin e grantit dhe që komunat, deri në qershor 2027, të miratojnë planet e shërbimeve sociale, ku çdo shërbim i ri të ketë staf dhe buxhet të siguruar para se të hapet. Komunat, Qendrat për Punë Sociale dhe ofruesit e shërbimeve duhet të kenë procedura të qarta për referimin e rasteve, ndërsa kuvendet komunale të mbikëqyrin nëse paratë po kthehen në shërbime për qytetarët.

Hyrje

Rastet e fundit të dhunës në familje, veçanërisht vrasja e Arlinda Zekajt, si dhe mangësitë e mundshme të reagimit institucional për garantimin e sigurisë së saj dhe trajtimin e kërcënimeve ndaj saj,[1] kanë sjellë në vëmendje edhe rolin dhe përgjegjësitë specifike të Qendrave për Punë Sociale. Për më tepër, Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2026 rikthen në vëmendje nevojën për financim të qëndrueshëm dhe për përmirësimin e shërbimeve sociale në nivel komunal.

Këto zhvillime nxjerrin në pah një çështje thelbësore: sa janë të përgatitura dhe të mbështetura financiarisht institucionet lokale për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve? Përgjigjja kërkon që reformat e financimit të lidhen drejtpërdrejt me nevojat e identifikuara nga qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve sociale.

Mbështetja për një fëmijë me aftësi të kufizuara, kujdesi për një të moshuar që jeton vetëm dhe mbrojtja e një viktime të dhunës në familje kërkojnë shërbime të qasshme, staf profesional dhe financim që garanton vazhdimësinë e tyre.

Gjetjet kryesore të raportit për Kosovën 2026

Sa i përket politikës sociale dhe punësimit, Komisioni Evropian vlerëson se Kosova ka një nivel të caktuar përgatitjeje dhe se progresi ka qenë i kufizuar. Rekomandimet e vitit të

[1] Kosovo Online, "Kur thirrja për ndihmë mbetet pa përgjigje: Vrasja e Arlinda Zekajt duhet të sjellë ndryshime në sistem", 2 nëntor 2026. https://www.kosovo-online.com/sq/lajm/analiza/kur-thirrja-ndihme-mbetet-pa-pergjigje-vrasja-e-arlinda-zekajt-duhet-te-sjelle

kaluar janë adresuar pjesërisht. Komisioni rekomandon rritjen e financimit dhe të cilësisë së shërbimeve komunale, përfshirë krijimin e një granti specifik për shërbime sociale në kuadër të legjislacionit për financat lokale.[2]

Sipas gjetjeve të raportit, kapacitetet për ofrimin e shërbimeve sociale cilësore janë të kufizuara për shkak të mungesës së financimit shumëvjeçar, numrit të pamjaftueshëm të punëtorëve socialë dhe pagave të ulëta të tyre. Komunat kanë kapacitete të dobëta për planifikimin e shërbimeve, mbledhjen e të dhënave dhe kujdesin e integruar. Kontraktimi i OJQ-ve nga Qeveria kërkon një qasje më të institucionalizuar, për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve. Komunat nuk kanë punësuar punëtorë të rinj socialë për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, siç parashikon legjislacioni.[3] Komunat veprojnë gjithashtu brenda një kornize fiskale kufizuese, pa mekanizëm për ndarjen e të ardhurave tatimore dhe me varësi të lartë nga transferet qendrore.[4]

Gjetjet e raportit tregojnë gjithashtu se sfidat e shërbimeve sociale nuk kufizohen te financimi dhe kapacitetet institucionale, por lidhen edhe me pabarazitë sociale dhe gjinore. Për personat me aftësi të kufizuara, ofrimi i pamjaftueshëm i shërbimeve e zhvendos barrën e kujdesit në mënyrë joproporcionale te familjet, veçanërisht te gratë.[5] Sipas raportit, përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit mund të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Në tre tremujorët e parë të vitit 2025, shkalla e papunësisë te gratë ishte 17,9%, krahasuar me 7,8% te burrat.[6]

Çfarë tregon puna jonë në terren?

Problemet e identifikuara në Raportin e Komisionit Evropian janë evidentuar edhe gjatë punës së Institutit me qytetarë, asambleistë, institucione komunale dhe organizata në Prizren, Istog, Kamenicë dhe Graçanicë. Konsultimet ofrojnë shembuj konkretë se si financimi, kapacitetet profesionale dhe organizimi i shërbimeve lidhen me nevojat e qytetarëve. Këta shembuj përbëjnë dëshmi cilësore dhe nuk përfaqësojnë një vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes në komunat përkatëse apo në të gjithë Kosovën.

Financimi dhe stafi

Vazhdimësia e financimit është një nga çështjet që kërkon zgjidhje. Analiza e Institutit për Prizrenin identifikon varësinë e shërbimeve të OJQ-ve nga subvencionet dhe ciklet e projekteve, si dhe nevojën për koordinim më sistematik. Ajo thekson gjithashtu se funksionalizimi i kapaciteteve të reja kërkon staf dhe buxhet operativ.[7] Në diskutimet në

[2] Komisioni Evropian, Kosovo 2026 Report, SWD(2026) 692 final, Bruksel, 4 nëntor 2026, kapitulli 19, f. 16. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2026_en

[3] Po aty, kapitulli 19, f. 87.

[4] Po aty, seksioni 2.1.2 – Reforma e administratës publike, f. 25.

[5] Po aty, kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore (personat me aftësi të kufizuara), f. 43–44.

[6] Po aty, kapitulli 19, f. 87.

[7] IPS MK, Politikat dhe Shërbimet Sociale në Komunën e Prizrenit, version për konsultim, në përfundim e sipër.

Graçanicë, numri i vogël i stafit dhe mungesa e një buxheti të veçantë për Qendrën për Punë Sociale u ngritën si pengesa për planifikimin. Mungesa e burimeve financiare kufizon gjithashtu mundësinë e angazhimit të personelit që mund të ofrojë shërbime në gjuhën shqipe.[8] Në Istog, Qendra për Punë Sociale (QPS) ka 13 punëtorë, por ky numër është i pamjaftueshëm, pasi vendet e liruara pas pensionimit të punonjësve nuk janë plotësuar ende.[9] Këto gjetje tregojnë se investimi në infrastrukturë, pa sigurimin e personelit dhe të buxhetit operativ, nuk garanton funksionimin e shërbimeve sociale.

Kujdesi për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara

Nevojat e ngritura në konsultime e bëjnë më konkrete rëndësinë e shërbimeve të qasshme dhe të qëndrueshme. Diskutimet në Istog dhe Graçanicë përfshinë nevojën për shërbime të qëndrimit ditor dhe mbështetjen për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në Istog u kërkuan edhe shërbime logopedike, terapeutike dhe mbështetje gjatë shkollimit.[10] Në Graçanicë u tha se nuk ka qendër ditore për këta fëmijë, gjë që pamundëson zhvillimin dhe socializimin e tyre.[11]

Kujdesi për të moshuarit dhe mbështetja për ata që jetojnë vetëm ishin gjithashtu pjesë e diskutimeve lokale. Mungesa e këtyre shërbimeve nuk ndikon vetëm në mirëqenien e përfituesve, por rrit edhe barrën e kujdesit të papaguar brenda familjes, e cila rëndon veçanërisht mbi gratë dhe kufizon mundësitë e tyre për punësim. Në Graçanicë pjesëmarrësit theksuan se mungesa e çerdheve publike i pengon disa gra të punësohen, sepse nuk kanë ku t'i lënë fëmijët.[12] Këto shqetësime të ngritura në nivel lokal përputhen me gjetjet e Komisionit për barrën e kujdesit mbi familjet dhe gratë.[13] Këto nevoja duhet të përkthehen në plane që përcaktojnë shërbimet prioritare, grupet e synuara dhe kostot përkatëse.

Planifikimi duhet të marrë parasysh edhe mundësinë reale të qytetarëve për të pasur qasje në shërbime. Çështja e transportit, e ngritur në Kamenicë, e ilustron këtë nevojë.[14] Një pasqyrë e integruar e shërbimeve duhet të tregojë cilat janë grupet e cenueshme, cilat vendbanime mbulohen, cilat grupe mbeten pa mbështetje dhe çfarë pengesash hasin përfituesit.

Gjetjet e Komisionit Evropian dhe përvojat nga konsultimet lokale nxjerrin në pah një problem të përbashkët: përgjegjësitë për ofrimin e shërbimeve sociale nuk shoqërohen gjithmonë me burimet financiare, njerëzore dhe organizative të nevojshme për

[8] Materialet dhe përmbledhjet e diskutimeve të IPS MK-së në Graçanicë, tetor 2026.
[9] Materialet dhe përmbledhjet e diskutimeve të IPS MK-së në Istog, tetor 2026.
[10] Po aty.
[11] Materialet dhe përmbledhjet e diskutimeve të IPS MK-së në Graçanicë, tetor 2026.
[12] Po aty;
[13] Komisioni Evropian, Kosovo 2026 Report, kapitulli 19, f. 87; kapitulli 23, f. 44.
[14] IPS MK, Politikat dhe Shërbimet Sociale në fokus të takimit me asambelistët në Kamenicë, shtator 2026. https://musineinstitute.org/politikat-dhe-sherbimet-sociale-ne-fokus-te-takimit-me-asambelistet-ne-kamenice/

përmbushjen e tyre. Prandaj, përmirësimi i shërbimeve kërkon jo vetëm rritje të financimit, por edhe planifikim të bazuar në nevoja, koordinim institucional dhe mbikëqyrje të zbatimit.

Rekomandimet kyçe

1. Financim i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm

Qeveria të përcaktojë hapat dhe afatin për krijimin e grantit specifik për shërbime sociale. Krijimi i këtij granti është kërkesë e artikuluar prej vitesh edhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, i cili që në vitin 2018 kërkoi që ky grant të përfshihej në ndryshimet e Ligjit për financat e pushtetit lokal.[15]

Shpërndarja e grantit të mbështetet në kritere transparente që marrin parasysh nevojat sociale dhe kapacitetet financiare të komunave. Financimi dhe kontraktimi shumëvjeçar të shoqërohen me standarde cilësie dhe mekanizma për mbikëqyrjen e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimeve.

2. Planifikim i bazuar në nevojat lokale

Deri në qershor 2027, komunat, në bashkëpunim me QPS-të, ofruesit e shërbimeve sociale, përfituesit e këtyre shërbimeve dhe familjet e tyre, të miratojnë planet e shërbimeve sociale të kërkuara nga legjislacioni. Ky afat do të mundësonte përfshirjen e nevojave dhe kostove përkatëse në planifikimin e buxhetit për vitin 2028.

Për çdo shërbim prioritar, plani të përcaktojë nevojën, koston, burimin e financimit, personelin, shpenzimet operative dhe afatin, përfshirë nevojat për punëtorë socialë që trajtojnë rastet e dhunës me bazë gjinore. Si shembull i planifikimit afatmesëm shërben Plani i Veprimit për Shërbime Sociale në Kryeqytet 2026–2028.[16]

3. Staf dhe kapacitete për funksionimin e shërbimeve

Që në fazën e planifikimit të një objekti për shërbime sociale, komunat të përcaktojnë cilat shërbime do të ofrohen, sa punonjës duhen dhe çfarë kualifikimesh e pajisjesh kërkohen. Krahas kostos së ndërtimit ose renovimit, buxheti të mbulojë pagat, trajnimin profesional dhe etik të stafit, pajisjet dhe shpenzimet e përditshme të funksionimit. Trajnimet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë trajtimit të rasteve të ndjeshme, respektimit të dinjitetit të përfituesve dhe qasjes pa diskriminim. Shërbimi të fillojë së

[15] Asociacioni i Komunave të Kosovës, Raporti narrativ i progresit 2018, f. 4, dhe Raporti narrativ i progresit 2019, f. 10. https://komunat-ks.net/raportet-vjetore/

[16] Komuna e Prishtinës, Plani i veprimit për shërbime sociale në Kryeqytet 2026–2028, Prishtinë, 2026. https://prishtina.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/1.1-Plani-i-veprimit-per-sherbime-sociale-ne-Kryeqytet-FINAL.pdf

funksionuari vetëm pasi të jenë siguruar fondet, personeli dhe pajisjet e nevojshme për ofrimin e tij që nga dita e hapjes.

4. Bashkërendimi ndërmjet institucioneve dhe referimi i rasteve

Drejtoritë komunale për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me Qendrat për Punë Sociale dhe ofruesit e shërbimeve sociale, të përcaktojnë përgjegjësitë e secilës palë dhe mënyrën e bashkëpunimit për orientimin e qytetarëve dhe ofrimin e shërbimeve. Procedurat e përbashkëta të përcaktojnë kush e referon rastin, kush e pranon dhe kush e ndjek deri në ofrimin e shërbimit.

Në rastet e dhunës në familje dhe të mbrojtjes së fëmijëve, këto procedura duhet të sigurojnë gjithashtu koordinim të qartë me policinë, prokurorinë, institucionet shëndetësore dhe mekanizmat e tjerë përgjegjës, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore. Për këto raste, është veçanërisht e rëndësishme që bashkëpunimi ndërinstitucional të mos kufizohet në referimin formal, por të përfshijë edhe ndjekjen e vazhdueshme të rastit, vlerësimin e rrezikut dhe reagimin në kohë ndaj nevojave për mbrojtje.

5. Mbikëqyrje dhe llogaridhënie në nivel komunal

Kuvendet komunale të forcojnë rolin e tyre mbikëqyrës në planifikimin, financimin dhe zbatimin e politikave dhe shërbimeve sociale. Planet, buxhetet dhe rezultatet e ofrimit të shërbimeve sociale të shqyrtohen çdo gjashtë muaj, ndërsa përfundimet dhe rekomandimet e këtyre shqyrtimeve të bëhen publike. Mbikëqyrja të përfshijë jo vetëm shpenzimin e mjeteve buxhetore, por edhe cilësinë, qasjen dhe vazhdimësinë e shërbimeve, si dhe përmbushjen e nevojave të qytetarëve. Gjatë vitit 2027, kuvendet komunale, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, të organizojnë trajnime për anëtarët e tyre, veçanërisht për asambleistët e rinj, mbi buxhetimin, politikat sociale dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

MUSINE KOKALARI
Instituti për Politika Sociale
Institut za Socijalne Politike - Institute for Social Policy

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit për Politika Sociale "Musine Kokalari" dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së apo Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

KCSF
FONDACIONI KOSOVAR PER SHOQERI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

www.musineinstitute.org

info@musineinstitute.org